

**UDHËZIM**  
**Nr.1, datë 29.12.2005**

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.703, DATË 16.11.2005**  
**“PËR FURNIZIMIN ME KARBURANT, PA AKCIZË, PËR MEKANIKËN BUJQËSORE,**  
**SERAT ME NGROHJE DHE SUBJEKTET QË KANË KALDAJA NË LINJAT E**  
**PËRPUNIMIT TË QUMËSHITIT”**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 16.11.2005 “Për furnizimin me karburant, pa akcizë, për mekanikën bujqësore, serat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit”

**UDHËZOJMË:**

**I – Të përgjithshme**

1. Skema për furnizimin me karburant pa akcizë (gazoil prodhim vendi/solar) për të gjithë fermerët dhe subjektet që përfitojnë nga ky vendim, do të përfshijë gjithë vitin bujqësor.

2. Do të furnizohen me karburant (gazoil prodhim vendi/solar) pa akcizë të gjithë fermerët, personat fizikë dhe juridikë që kryejnë punime të mekanizuara në bujqësi, serat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit në të gjithë vendin.

3. Fermerët të cilët nuk paguajnë detyrimin për taksën e tokës bujqësore, sipas ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, kur komuna/bashkia e ka aplikuar këtë taksë, si dhe fermerët e komunave/bashkive të cilët nuk e aplikojnë taksën e tokës bujqësore, përjashtohen nga skema e furnizimit me karburant (gazoil prodhim vendi/solar) pa akcizë.

4. Drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, të përgatisin regjistrin e fermerëve, që të shërbejë për përlllogaritjet e sasisë së karburantit (gazoil prodhim vendi/solar) për çdo përfitues.

5. Për programimin, koordinimin dhe monitorimin e kësaj skeme shpërndarje ngarkohet Njësia e Menaxhimit të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor”, 2KR.

6. Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, pranë çdo bashkie/komune do të funksionojë një grup pune i përbërë nga:

- Kryetari i bashkisë/komunës;
- Përfaqësuesi i projektit 2KR;
- Përgjegjësi i degës së financës së bashkisë/komunës;
- Specialisti i komunës për bujqësinë/kadastrën;
- Përfaqësuesi i DRBUMK;
- Kryetari i fshatit.

Ky grup pune, i kryesuar nga kryetari i bashkisë/komunës, është përgjegjës për funksionimin e skemës së shpërndarjes së karburantit (gazoil prodhim vendi/solar) për fermerët dhe subjektet brenda njësive administrative ku vepron, dhe ka për detyrë:

a) Të përgatisë dhe administrojë gjithë dokumentacionin përkatës sipas tabelave bashkëlidhur;

b) Të grumbullojë, përpunojë dhe shqyrtojë të gjitha kërkesat e fermerëve, si dhe të përcaktojë sasisë e karburantit që përfiton çdo fermer;

c) Të garantojë rakordimin e sipërfaqes së tokës së fermerëve me kadastrën e komunës/bashkisë dhe, nëse është nevoja, me Seksionin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në qark;

d) Të miratojë listën përfundimtare të përfituesve dhe të mbikëqyrë gjithë procesin e shpërndarjes së tollonave brenda komunës/bashkisë.

7. Llogaritja e nevojave për karburant (gazoil prodhim vendi/solar) pa akcizë do të bëhet mbi bazë:

- të sipërfaqes së tokës së mekanizuar për çdo kulturë;
- të normativave të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për harxhim të karburantit të detajuar sipas llojit të tokës dhe kulturave (pasqyra nr.7).

8. Karburanti (gazoil prodhim vendi) pa akcizë sigurohet nga “ARMO” sh.a., e cila do të furnizojë kundrejt pagesës 40 lekë/litrë pikat e miratuara të shpërndarjes së karburantit pa akcizë

gjatë gjithë vitit sipas planit të përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Projektit 2KR dhe miratuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9. Pikat e shpërndarjes së karburantit, që do të furnizohen nga “ARMO” sh.a., propozohen nga organet e pushtetit vendor pranë projektit 2KR, të pajisura me dokumentacionin përkatës në përputhje me procedurat ligjore në fuqi (pasqyra 7/1) dhe miratohen nga Ministri i Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Shpërndarja e karburantit (gazoil prodhim vendi) pa akcizë të përfituesit do të bëhet me tollona dhe çmimi i blerjes nga fermeri do të jetë 40 lekë/litër. Diferenca mes çmimit të programuar vjetor të ARMO sh.a. të gazoilit, prodhim vendi, pa akcizë dhe çmimit prej 40 lekë/litër i paguar nga përfituesi, si dhe kostoja për kryerjen e shërbimit nga pikat e shpërndarjes që nuk janë të “ARMO” sh.a. me një vlerë prej 5 lekë/litër do të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

11. Subjektet që përfitojnë solar, do të furnizohen kundrejt pagesës (çmimi i programuar i ARMO sh.a. pa akcizë) pranë degëve të furnizimit të shpërndarjes së karburantit të ARMO sh.a.(DSHK), sipas listave të miratuara nga bashkia/komuna dhe autorizimit që këto të fundit do të lëshojnë për përfituesin.

12. Shpërndarja e tollonave bashkive/komunave bëhet nga Njësia e Menaxhimit të Projektit 2KR me paraqitjen nga bashkia/komuna të formularit përkatës, sipas pasqyrës nr. 4.

13. Shpërndarja e tollonave të karburantit (gazoil prodhim vendi) për subjektet përfituese do të bëhet nga bashkia/komuna sipas listës së miratuar të përfituesve, të cilët paguajnë vlerën sipas çmimit të miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave 40 lekë/litër.

14. Vlera e arkëtuar në komunë/bashki nga shitja e tollonave do të xhirohet në llogarinë e projektit 2KR çdo 2 muaj. Pikat e shpërndarjes së karburantit dorëzojnë tollonat e grumbulluara nga përfituesit pranë projektit 2KR, i cili u bën likuidimin këtyre pikave për sasinë e furnizuar llogaritur me vlerën 40 lekë/litër(për gazoilin prodhim vendi), si dhe për shërbimin e kryer me vlerën 5 lekë/litër karburant të shpërndarë.

15. Tollonat për karburantin gazoil prodhim vendi, pa akcizë do të porositen për t’u prodhuar në mënyrë të përqendruar nga Njësia e Menaxhimit të Projektit, me elemente sigurie. Tollonat përkatëse për gazoilin prodhim vendi do të prodhohen për sasinë 10, 20, 50 dhe 100 dhe do të përdoren brenda vitit bujqësor.

16. Projekti 2KR bën rakordimin me ARMO sh.a. çdo 4 muaj dhe xhiron në favor të saj diferencën ndërmjet çmimit të programuar të gazoilit, prodhim vendi, pa akcizë, me çmimin 40 lekë/litër të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

17. Një kopje e aktrakordimit dërgohet nga projekti 2KR në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim-Taksave për efekt të përjashtimit nga akciza të sasisë së gazoilit dhe solarit të shpërndarë.

## II – Procedurat dhe skemat e furnizimit me karburant

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.703, datë 16.11.2005, miraton sasinë e karburantit (gazoil prodhim vendi/solar) për çdo bashki/komunë mbi bazën e propozimit të Njësies së Menaxhimit të Projektit 2KR.

Përcaktimi i nevojave për karburant dhe shpërndarja e tollonave

Për fermerët

1. Fermeri ia paraqet grupit të punës së bashkisë/komunës kërkesën për karburant (gazoil, prodhim vendi), pa akcizë sipas pasqyrës nr.1. Afatet e paraqitjes së kërkesave përcaktohen nga grupi i punës i bashkisë/komunës, të cilat publikohen në ambiente publike.

2. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për karburant (gazoil, prodhim vendi) nga fermeri, specialisti i bujqësisë i komunës/bashkisë, së bashku me fermerin, plotësojnë “Kartelën individuale të fermës”, e cila është elementi baze i “Regjistrit të fermave”. Kjo kartelë (pasqyra nr.2) përgatitet në tri kopje, njëra depozitohet në komunë/bashki, një në DRBUMK dhe e treta mbahet nga fermeri.

3. DRBUMK grumbullon kartelat nga të gjitha komunat/bashkitë dhe harton regjistrin e fermerëve në nivel qarku.

4. Bazuar në kërkesën e fermerit, kartelën individuale të fermës, normativat e harxhimit të karburantit (gazoil, prodhim vendi), specialisti i bujqësisë i komunës/bashkisë llogarit sasinë përkatëse që do të përfitojë fermeri.

5. Përmbledhësja e kërkesave për karburant (gazoil, prodhim vendi) për të gjithë

bashkinë/komunën, e përgatitur nga specialisti i bujqësisë, hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të punës. Një kopje i dorëzohet Njesisë së Menaxhimit të Projektit, 2KR, e cila bën përmbledhësen e kërkesave në shkallë vendi. Një kopje mbetet në bashkinë/komunën përkatëse (pasqyrat nr.3, 4).

6. Pas miratimit të kërkesës së komunës/bashkisë nga Njësia e Menaxhimit të Projektit 2KR, komuna/bashkia shpall në ambiente publike listën e përfituesve me sasi të përkatëse, për një periudhë jo më pak se 10 ditë nga data e miratimit (pasqyra nr.5).

7. Kryetari i bashkisë/komunës organizon punën për tërheqjen e tollonave pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit 2KR. Administrimi dhe shpërndarja e tollonave sipas listës së miratuar të përfituesve, kundrejt pagesës 40 lekë/litër, bëhet nga zyra e financës së komunës/bashkisë sipas pasqyrës nr.6.

Për serat

1. Furnizimi me gazoil, prodhim vendi me çmim 40 lekë/litër ose solar pa akcizë, do të bëhet për periudhën 1 nëntor-30 prill, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

2. Poseduesi i serës paraqet pranë grupit të punës kërkesën për furnizim sipas pasqyrës nr.8.

3. Specialisti i bashkisë/komunës, së bashku me përfaqësuesin e DRBUMK, do të kontrollojnë vërtetësinë e kërkesës dhe do të llogarisin sasi të përkatëse të gazoilit, prodhim vendi ose solarit që do të përfitojë aplikuesi sipas pasqyrave nr.9, 10 e detajuar mbi bazën e normativës së miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave.

4. Përfitimi i gazoilit, prodhim vendi me çmim 40 lekë/litër ose solar pa akcizë i poseduesve të serave, do të bëhet me faza, pasi të jenë pasqyruar me akte verifikimi të gjitha proceset e punës sipas sezonit. Aktet e verifikimit detyrimisht duhet të nënshkruhen nga: përfaqësuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projektit, 2KR, specialisti i komunës/bashkisë dhe përfaqësuesi i DRBUMK. Akti i verifikimit do të mbahet sipas pasqyrës nr.11.

5. Tërheqja e tollonave të karburantit (gazoil, prodhim vendi/solar) bëhet pranë zyrës së financës së bashkisë/komunës. Të dhënat, si dhe për përfituesit e tjerë pasqyrohen në listën e përfituesve (pasqyra nr.6).

Për linjat e përpunimit të qumështit që punojnë me kaldaja

1. Furnizimi me gazoil, prodhim vendi me çmim 40 lekë/litër ose solar pa akcizë do të bëhet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të regjistruar në degën e tatim-taksave të rrethit përkatës.

2. Subjektet përpunuese bëjnë kërkesën për sasinë vjetore të gazoilit ose solarit pranë grupit të punës në bashki/komunë sipas pasqyrës nr.12.

3. Specialisti i bashkisë/komunës, së bashku me përfaqësuesin e DRBUMK, do të kontrollojnë vërtetësinë e kërkesës dhe do të llogarisin sasi të përkatëse të gazoilit, prodhim vendi ose solarit që do të përfitojë aplikuesi sipas pasqyrës nr.13, e detajuar mbi bazën e normativës së miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave. Kjo pasqyrë firmoset nga grupi i punës.

4. Përfitimi i gazoilit, prodhim vendi me çmim 40 lekë/litër ose solar pa akcizë i poseduesve të linjave të përpunimit të qumështit, do të bëhet me faza, pasi të jetë evidentuar dhe kontrolluar kapaciteti prodhues/ përpunues i linjës në vazhdimësi, si dhe i pasqyruar me akte verifikimi. Aktet e verifikimit detyrimisht duhet të nënshkruhen nga: përfaqësuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projektit 2KR, specialisti i komunës/bashkisë dhe përfaqësuesi DRBUMK. Akti i verifikimit do të mbahet sipas pasqyrës nr.14.

5. Tërheqja e tollonave të karburantit gazoil, prodhim vendi bëhet pranë zyrës së financës së bashkisë/komunës. Të dhënat, si dhe për përfituesit e tjerë pasqyrohen në listën e përfituesve (pasqyra nr.6).

Furnizimi me karburant (gazoil, prodhim vendi/solar)

1. Furnizimi me gazoil, prodhim vendi për të gjithë përfituesit do të bëhet në pikat e shpërndarjes së karburantit, të miratuara nga MBUMK.

2. Furnizimi për subjektet që përfitojnë solar do të bëhet pranë degëve të furnizimit të shpërndarjes së karburantit të ARMO sh.a.

3. Pikat e shpërndarjes do të furnizohen me gazoil, prodhim vendi nga "ARMO"sh.a. sipas planit të furnizimit të hartuar nga Njësia e Menaxhimit të Projektit 2KR dhe të miratuar nga MBUMK. Për këtë, midis "ARMO"sh.a. dhe MBUMK lidhet një kontratë, në të cilën duhet të përcaktohen

përveç të tjerash edhe:

- Sasitë e furnizimit me karburant (gazoil, prodhim vendi/solar) sipas standardit.
- Subjektet që do të tërheqin karburantin (gazoil, prodhim vendi) pranë pikave të furnizimit me pakicë dhe grafiku i furnizimit.
- Sasitë, si dhe pikat e furnizimit me solar të DSHK-ve.
- Afatet e rakordimit midis “ARMO”sh.a., pikave të shitjes me pakicë dhe projektit 2KR.

### III. Kontrolli për administrimin e skemës së shpërndarjes së karburantit

- Dokumentacioni bashkëlidhur këtij udhëzimi të jetë i plotësuar pa korrigjime, i firmosur dhe i vulosur nga bashkia/komuna.

- Kur përfituesi i karburantit (gazoil, prodhim vendi/solar) pa akcizë nuk zbaton kriteret e këtij udhëzimi, grupi i punës e përjashton këtë nga lista e furnizimit me karburant. Fermeri ka të drejtë të ankohet te grupi i punës në bashki/komunë brenda 5 ditëve. Grupi i punës brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës i jep përgjigje ankuesit.

- Projekti 2KR ka për detyrë të grumbullojë dhe të ruajë dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim sipas afateve ligjore të miratuara.

- Projekti 2KR i propozon MBUMK sasinë e furnizimit me karburant (gazoil, prodhim vendi/solar) për çdo bashki/komunë dhe subjektet e caktuara për shpërndarjen e karburantit.

- Projekti 2KR emeton dhe shpërndan tollonat sipas dokumentacionit të miratuar, si dhe grumbullon dhe administron tollonat e përdorura.

- Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në planin e kontrollit, kur e gjykon të nevojshme, kërkon ngritjen e grupeve të auditimit mbi funksionimin e të gjithë skemës së shpërndarjes së karburantit.

- Në rast se konstatohen shkelje të rregullave për administrimin dhe menaxhimin e këtij procesi, nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit u propozohen sipas rastit organeve kompetente masa disiplinore apo zhdëmtimi për grupet e punës apo individë që shkelin rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

- Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit  
dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  
Jemin Gjana

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe  
Energjetikës  
Genc Ruli

Ministri i Financave  
Ridvan Bode

Ministri i Brendshëm  
Sokol Olldashi

Pasqyra nr 1\_

K Ë R K E S Ë

Rrethi\_\_\_\_\_

BASHKIA/KOMUNA\_\_\_\_\_

Fshati\_\_\_\_\_

Une i nenshkruari \_\_\_\_\_ kerkoj te kryej punime te mekanizuar per periudhen \_\_\_\_\_

| Nr | Kulturat | Njesia matëse | Siperfaqja |
|----|----------|---------------|------------|
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    |          |               |            |
|    | TOTALI   |               |            |

Date \_\_\_\_\_

Kërkuesi: \_\_\_\_\_

**KARTELA E FERMERIT**

| Qarku | Rrethi | Komuna | Fshati | Emri Mbiemri i fermerit |
|-------|--------|--------|--------|-------------------------|
|-------|--------|--------|--------|-------------------------|

| Nr. Antareve te familjes | Krahe pune total | Krahe pune ne bujqesi |
|--------------------------|------------------|-----------------------|
|--------------------------|------------------|-----------------------|

**Viti bujqesor 2005-2006**

| Nr. | Toka<br>Siperfaqja e sipas<br>parcelave | Nr. sipas<br>Kadastres | Punimi tokes   |           |          | Siperfaqja e<br>ujitur ne fakt |
|-----|-----------------------------------------|------------------------|----------------|-----------|----------|--------------------------------|
|     |                                         |                        | Me<br>mekanike | Me kafshe | Me krahe |                                |

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7

Total

| Bimet e arave |  | Lloji i tokes (dy) |            |            | Siperfaqja e<br>mbjelle<br>gjate 2005-<br>06 | Siperfaqja e<br>mekanizuar<br>gjate 2005-06 | Siperfaqja<br>e ujitur<br>gjate<br>2005-06 |
|---------------|--|--------------------|------------|------------|----------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------|
|               |  | E<br>lehte         | E<br>mesme | E<br>rende |                                              |                                             |                                            |

1 Grure  
2 Te lashta te tjera  
3 Miser  
4 Jonxhe  
5 Foragjere te tjera I  
6 Foragjere te tjera II  
7 Perime fushe  
8 Patate  
9 Fasule  
10 Te tjera  
Total

| Sera, | Siperfaqja faktike<br>2005-06 | Viti i<br>ngritjes | Siperfaqja e<br>mekanizuar | Siperfaqja e<br>ujitur |
|-------|-------------------------------|--------------------|----------------------------|------------------------|
|-------|-------------------------------|--------------------|----------------------------|------------------------|

1 Sere pa ngrohje  
2 Sere me ngrohje  
Total

| Vreshte, Pemtores |  | Siperfaqja<br>faktike<br>2005-06 | Numeri i<br>rrenjeve | Viti i<br>ngritjes | Siperfaqja e<br>mekanizuar | Siperfaqja e<br>ujitur |
|-------------------|--|----------------------------------|----------------------|--------------------|----------------------------|------------------------|
|-------------------|--|----------------------------------|----------------------|--------------------|----------------------------|------------------------|

3 Pjergulla  
4 Vreshte  
5 Pemtores  
6 Ullishte  
7 Agrume

| Blegtoria | Numri i<br>krereve | A shisni ndonje nga<br>produktet e<br>meposhtme? | Po | Jo |
|-----------|--------------------|--------------------------------------------------|----|----|
|-----------|--------------------|--------------------------------------------------|----|----|

|    |                 |                               |
|----|-----------------|-------------------------------|
| 1  | Lope qumeshti   | Drithera (grure, miser, etj.) |
| 2  | Qe              | Fruta - perime te fresketa    |
| 3  | Meshqerra       | Fruta - perime te perpunuara  |
| 4  | Vica            | Patate, fasule                |
| 5  | Dele            | Produkte te tjera bimore      |
| 6  | Desh            | Mish gjedhi te fresket        |
| 7  | Qingja          | Mish dele te fresket          |
| 8  | Dhi             | Midh dhie te fresket          |
| 9  | Cjep            | Mish te perpunuar             |
| 10 | Keca            | Shpende                       |
| 11 | Pula deti       | Qumesh te fresket             |
| 12 | Pula fushe      | Bulment                       |
| 13 | Shpend te tjera |                               |

| I. Traktora             |                          |           |               | II. Autokombajna |                |                 |          |
|-------------------------|--------------------------|-----------|---------------|------------------|----------------|-----------------|----------|
| Gjithsej                | Tipi                     | Kuaj Fuqi | Viti Prodhimt | Gjithsej         | Autokomb Gruri | Autokomb Misri  |          |
|                         |                          |           |               |                  |                |                 |          |
|                         |                          |           |               |                  |                |                 |          |
| III. Makineri bujqesore |                          |           |               |                  |                |                 |          |
| Gjithsej                | Sipas llojeve dhe tipeve |           |               |                  |                |                 |          |
|                         | Plug                     | Disk      | Freze         | Makine mbjellese | Rimorkio       | Pompe Sperkates | Te tjera |
|                         |                          |           |               |                  |                |                 |          |
|                         |                          |           |               |                  |                |                 |          |
|                         |                          |           |               |                  |                |                 |          |

|                |                                 |
|----------------|---------------------------------|
| <b>Fermeri</b> | <b>Sp. Bujqesise se Komunes</b> |
| Ermi Mbiemri   | Ermi Mbiemri                    |
| Firma          | Firma                           |
| Data           | Data                            |

## PËRMBLEDHËSE E KËRKESAVE PËR KARBURANT

(gazoil prodhim vendi/solar)

RRETHI \_\_\_\_\_ KOMUNA \_\_\_\_\_ FSHATI \_\_\_\_\_

| Nr. | Emri, mbiemri i perfituesit | Nr i certifikates se pronesise | Siperfaqja e mbjelle, numri i proçeseve te mekanizuara me traktore dhe nevojat per nafte per çdo kulture |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       | Siperfaqja e pergjitheshme e mekanizuar dhe sasia e naftes |       |
|-----|-----------------------------|--------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------------------|-------|-------------------|-------|-------------------|-------|-------------------|-------|-------------------|-------|------------------------------------------------------------|-------|
|     |                             |                                | Grure e te lashta                                                                                        |       | Miser             |       | Perime            |       | Frutikulture      |       | Foragjere te para |       | Foragjere te dyta |       |                                                            |       |
|     |                             |                                | Sip. E mekanizuardy                                                                                      | Litra | Sip. E mekanizuar | Litra | Sip. E mekanizuar | Litra | Sip. E mekanizuar | Litra | Sip. E mekanizuar | Litra | Sip. E mekanizuar | Litra | Sip. E mekanizuar                                          | Litra |
| a   | b                           | c                              | 1                                                                                                        | 2     | 3                 | 4     | 5                 | 6     | 7                 | 8     | 9                 | 10    | 11                | 12    | 13                                                         | 14    |
| 1   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 2   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 3   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 4   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 5   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 6   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 7   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 8   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 9   |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 10  |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 11  |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 12  |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 13  |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
| 14  |                             |                                |                                                                                                          |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                   |       |                                                            |       |
